

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE, BASHKIA FIER

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Fier, me objekt “Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” për periudhën nga data 01.01.2013 deri 31.03.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimet e Kryetarit të KLSH-së nr. 58, datë 13.06.2014 dhe nr. 87, datë 17.07.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 323/6, datë 13.06.2014 dhe nr. 323/9, datë 17.07.2014, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse, i janë dërguar z. Baftjar Zeqo, Kryetar i Bashkisë, Fier.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1- Të merren masa dhe të ndiqen të gjitha hapat ligjore për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së me shkresën nr. 245/12, datë 04.09.2013, por të pa zbatuara plotësisht.

2- Nga Bashkia Fier të ngrihet një grup pune me punonjës të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, në bashkëpunim me punonjës të katër njësive administrative, punonjës të urbanistikës, auditit të brendshëm me qëllim që:

-Të kryej inventarizimin e të gjithë subjekteve të cilët janë objekt i taksave vendore dhe të plotësohet një regjistër me të dhënat përkatëse, të plotësohen dosjet e subjekteve me dokumente që informojnë në mënyrë kronologjike veprimtarinë e tatimpaguesit, të tilla si kartela të viteve të kaluara, pagesat nga bankat, llogaritjet e xhiros, aktverifikimet e inspektorëve, të dhëna për aplikimin e gjobave, lloje të ndryshme dokumentesh të pronësisë etj., dhe të ushtrohet kontroll në subjekte për llogaritjen e detyrimeve tatimore, mbajtjen e regjistrave dhe kryerjen e pagesave të tatimeve në përputhje me procedurat dhe afatet e përcaktuara në legjislacionin tatimor.

-Të evidentojë subjektet që ushtrojnë aktivitet pa leje dhe të merren masat përkatëse ligjore për regjistrimin e tyre dhe llogaritjen e arkëtimit e detyrimeve përkatëse vendore.

-Të bëjë verifikime për gjithë subjektet që nuk kanë deklaruar xhiron vjetore të vitit 2013, dhe pasi të shqyrtojë ato, ti pasqyrojë në detyrimin llogaritur për vitin 2014.

- Të selektohen emrat e taksapaguesve për taksën e ndërtesës duke bërë rakordimin midis regjistrit të gjendjes civile dhe regjistrit të rajoneve për taksapaguesit që nuk figurojnë të kenë likuiduar taksën e ndërtesës për vitin 2013, të konfirmohen sipërfaqet e taksueshme për çdo familje nga ZVRPP, Fier dhe, mbi bazën e rezultateve, të ndërtohet një program pune për llogaritjen e shumës për çdo taksapagues, shpalljen debitor, njoftimin e detyrimit dhe të merren masat sipas ligjit për arkëtimit e detyrimeve.

3- Nga Bashkia Fier, ti kërkohet shoqërisë [REDAKTUAR], e cila ka implementuar programin kompjuterik, që të kryejë korigjimet në program, me qëllim që për mospagesën në afat, subjektet të mos ngarkohen në mënyrë automatike me gjobë në masën 25%, pavarësisht nga ditët, në përputhje me nenin 114 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, ku përcaktohet se gjoba për pagesat e vonuara duhet të jetë e diferencuar në masën 5% në muaj, por jo më shumë se 25% të detyrimit (rekomandim i mëparshëm i pa zbatuar). Të strukturohet gjenerimi i raporteve me qëllim që për të gjithë subjektet fizike dhe juridike objekt i pagesës së taksave, ku në to përveç NIPT-it, llojit të aktivitetit, adresës, të pasqyrohen detyrimet vjetore sipas llojit të taksës, me afate të përputhura me ato të përcaktuar në ligj, numri dhe data e pagesës si dhe të bëhet e mundur kryerja e printimit të regjistrave në fund të çdo viti duke i arkivuar në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

4- Të merren masa nga DPTTV, Bashkia Fier, që nga Sektori i Verifikimit në Terren dhe Sektori i Kontrollit Tatimor dhe Analizës së Riskut, të hartohen plane pune vjetore dhe mujore të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme si dhe të kryhet në mënyrë të dokumentuar llogaritja e riskut për kryerjen e kontrolleve në terren.

5- Nga DPTTV të merren masa për zbatim më të drejtë të Vendimit të Këshillit Bashkiak Fier nr. 59, datë 28.12.2012, për të lidhur marrëveshje ose kontrata bashkëpunimi me agjentë tatimor si DRSHT, ZRPP, Ujësjiellësi ose shoqërinë “CEZ Shpërndarje” sha, për taksat dhe tarifrat që ato arkëtojnë për llogari të buxhetit bashkiak duke siguruar informacione për arkëtimin e tyre sipas pasqyrave e anekseve të parashikuara në ligjin mbi taksat vendore.

6- Nga DPTTV, Drejtoria e Mbledhjes dhe Vlerësimit për të gjithë subjektet me borxh dhe pa masë të evidentuar në aneksin 6 dhe 7, të merren masat shtrënguese të parashikuara në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”. Për të gjithë subjektet me borxh të vitit 2011 të merren masat e sekuestros së pasurisë dhe atë të transferimit të detyrimit tatimor palës së tretë.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Fier, të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për arkëtimin e detyrimeve për vlerën **27,090,400 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Të bëhet llogaritja dhe arkëtimi i vlerës së penaltetit prej **2,725,000 lekë**, për 109 subjekte të përshkruara në faqet 38-39 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2. Të bëhet llogaritja dhe arkëtimi i vlerës së taksës së pastrimit, ndricimit dhe gjelbërimit, të marra së bashku, të pa vjelura për vitin 2013 dhe tre mujorin e parë të vitit 2014 sipas klasifikimit të përcaktuar në VKB nr. 59, datë 28.12.2012 për shumën **24,365,400 lekë**, të përshkruara në faqen 35 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

3. Të bëhet llogaritja dhe vjelja e taksës së reklamës për vitin 2013 në vlerën **22,500 lekë** dhe për vitin 2014 në vlerën **22,500 lekë**, për subjektin [REDAKTUAR], me numër NIPT-i [REDAKTUAR] e përshkruar në faqen 25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

C. MASA DISIPLINORE

1. Mbështetur në Udhëzimin nr. 28, datë 15.12.2011 “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike”, pika 13 dhe 17, i është tërhequr vëmendja Kryetarit të Bashkisë Fier, për moszbatimin e rekomandimeve tona të auditimit të mëparshëm të KLSH-së, dhe i është kërkuar të përfshihet kjo në raportin vjetor të cilësisë së kontrollit të brendshëm në njësinë publike. Gjithashtu i është kërkuar që të marrë masa disiplinore për punonjësit e angazhuar në zbatimin e rekomandimeve.

2. Mbështetur në nenin 57 dhe 58, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nënpunësin Civil”, i është kërkuar Kryetarit të Bashkisë Fier, që të fillojë procedura për dhënien e masës disiplinore:

I. “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, neni 57, pika 3, gërma a) neni 58, gërma c), për 3 punonjës:

1. [REDAKTUAR], 2. [REDAKTUAR] dhe 3. [REDAKTUAR], me detyrë, specialistë zone në Drejtorinë e Mbledhjes dhe Vlerësimit.

-Pasi, nuk kanë marrë masat e nevojshme për mbledhjen dhe recuperim e borxhit, bazuar në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” si dhe VKB nr. 52, datë 28.12.2012, e cilësuar në procesverbalin nr. 1, datë 21.04.2014; Nuk kanë bërë vjelien e detyrimeve për taksën mbi ndërtesën për vitin 2013 dhe 3 mujorin e parë të vitit 2014 sipas klasifikimit të përcaktuar në VKB nr. 59, datë 28.12.2012, e cilësuar në procesverbalin nr. 3 datë 21.04.2014; Nuk kanë përpiluar dhe përditësuar dosjet e subjekteve konform rregullimeve të ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, e cilësuar në procesverbalin nr. 4, datë 21.04.2014.

II. “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj”, neni 57, pika 3, gërma a) si dhe neni 58, gërma b), për 7 punonjës:

1. [REDAKTUAR] me detyrë Drejtore e DPTTV, Bashkia Fier dhe
2. [REDAKTUAR] me detyrë ish Drejtor i DPTTV, aktualisht Drejtor i Përgjithshëm i Financës, Bashkia Fier.

-Pasi nuk kanë marrë masat e nevojshme për mbledhjen dhe recuperimin e borxhit, e cilësuar në procesverbalin nr. 1, datë 21.04.2014; Nuk kanë zbatuar procedurat e

sekuestrimit dhe nuk ka bërë penalizimin me nga 25,000 lekë për 109 subjekte me vlerë totale prej 2,725,000 lekë, për subjektet që ushtrojnë aktivitet pa leje, bazuar në nenin 41 dhe 112 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, e cilësuar në procesverbalin nr. 2, datë 21.04.2014; Nuk kanë bërë vjelien e detyrimeve për taksën mbi ndërtesën për vitin 2013 dhe 3 mujorin e parë të vitit 2014 sipas klasifikimit të përcaktuar në VKB nr. 59, datë 28.12.2012, e cilësuar në procesverbalin nr. 3, datë 21.04.2014; Nuk kanë bërë vjelien në buxhetin vendor të taksës së pastrimit, ndricimit dhe gjelbërimit të marra së bashku për vitin 2013 dhe tre mujorin e parë të vitit 2014 sipas klasifikimit të përcaktuar në VKB nr. 59, datë 28.12.2012, e cilësuar në procesverbalin nr. 3 datë 21.04.2014; Nuk kanë lidhur marrëveshje ose kontrata bashkëpunimi me agjentët tatimor DRSHT, ZRPP, Ujësjetllësi ose “CEZ Shpërndarje” sha, për të bashkëpunuar në vjelien e taksave dhe tarifave për llogari të buxhetit bashkiak, duke siguruar informacione për arkëtimin e tyre sipas pasqyrave e anekseve të parashikuara në ligjin mbi taksat vendore, në mbështetje ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” si dhe të VKB nr. 59, datë 28.12.2012, e cilësuar në procesverbalin nr. 4, datë 21.04.2014; Nuk kanë përpiluar dhe përditësuar dosjet e subjekteve konform rregullimeve të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, e cilësuar në procesverbalin nr. 4, datë 21.04.2014.

3. [REDAKTUAR], me detyrë Drejtore e Sektorit të Kontrollit në DPTTV, Bashkia Fier.

-Për moszbatimin e procedurave të sekuestrimit dhe mospenalizmin me nga 25,000 lekë për 109 subjekte me vlerë totale prej 2,725,000 lekë, që ushtrojnë aktivitet pa leje, bazuar në nenin 41 dhe 112 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, e cilësuar në procesverbalin nr. 2, datë 21.04.2014.

4. [REDAKTUAR] 5. [REDAKTUAR] 6. [REDAKTUAR] 7. [REDAKTUAR], me detyrë specialistë në Drejtorinë e Kontrollit, në DPTTV, Bashkia Fier.

-Për moszbatimin e procedurave të sekuestrimit dhe mospenalizimin me nga 25,000 lekë për subjektet që ushtrojnë aktivitet pa leje, bazuar në nenin 41 dhe 112 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, e cilësuar në procesverbalin nr. 2, datë 21.04.2014.

III. “Vërejtje”, neni 57, pika 3, germa a) si dhe neni 58, gërma a), për 5 punonjës:

1. [REDAKTUAR] me detyrë Drejtore e Përgjithshme e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, Bashkia Fier.

-Pasi nuk ka bashkërenduar punën me Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore duke mos evidentuar detyrimet për taksat e ndërtesës, e cilësuar në procesverbalin nr. 3, datë 21.04.2014.

2. [REDAKTUAR] 3. [REDAKTUAR] 4. [REDAKTUAR] dhe 5. [REDAKTUAR] me detyrë specialistë.

-Për vjelien e taksës së ndërtesës në Njësinë Administrative Rajonale, Bashkia Fier, për mosevidentim dhe vjelien e taksës së ndërtesës, e cilësuar në procesverbalin nr. 4, datë 21.04.2014.

Me ndjekien dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit.

Auditimi u krye nga audituesit Edvin Stefani, p/grupi, Bashkim Shehu, Hodo Hasani, Xhovan Domi, më tej u shqyrtua nga Kryeauditues z. Albert Thoma, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Sigurimit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Departamentit znj. Albana Agolli si dhe u verifikua si praktikë nga Sekretari i Përgjithshëm, znj. Luljeta Nano.

Mbi zbatimin e rekomandimeve:

DPTTV, Bashkia Fier me shkresat nr. 560/24, datë 15.07.2014 dhe nr. 323/11, datë 18.07.2014 ka kthyer përgjigje për zbatimin e rekomandimeve nga ku rezulton se është hartuar një Program Masash me nr. 560/22, datë 14.07.2014 “Për riparimin e të metave të konstatuara në zbatim të rekomandimeve të KLSH” ku janë vlerësuar dhe janë marrë masat përkatëse për zbatimin e masave organizative të propozuara. Me urdhërin nr. 560/23, datë 14.07.2014 është urdhëruar kontabilizimi në llogarinë debitore vetëm për shumën 22,500 lekë, nga 27,090,400 lekë të rekomanduara, si dhe janë dhënë 4 (katër) masa disiplinore “vëretje”, nga 15 (pesëmbëdhjetë) masa disiplinore të propozuara gjithsej.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT